SEMINARI I FUSHËS FROJDIANE NË SHQIPËRI
RRETHI LAKANIAN SHQIPTAR

Transferenca në veprën e Frojdit

Geert Hoornaert



2 Dhjetor 2017
9h00-14h00

Biblioteka Kombëtare
Sheshi Skënderbej

ASSOCIATION DE LA FONDATION DU CHAMP FREUDIEN
74, rue d'Assas - 75 006 Paris
Tél : 01 45 48 56 72 – Fax : 01 45 48 79 38

SEMINARI I FUSHES FROJDIANE NE SHQIPERI
Paraqitje e përgjithshme

Seminari do të mbahet nga lektori i Fushës frojdjane**, Geert Hoornaert** anëtar i Shoqatës Botërore të Psikanalizës (AMP).
Ky cikël seminaresh organizohet nga Judith Miller, presidente e Shoqatës së Fondacionit të Fushës Frojdiane, vajza e psikanalistit Jacques Lacan.

Seminari do të zhvillohet sipas kalendarit të paracaktuar për 2017-2018:
- Sesioni i parë në 2 dhjetor nga **Geert Hoornaert,** psikanalist në Belgjikë.

Organizuar nga sekretariati i NLS-Est

Regjistrimet kryhen në adresën elektronike ***seminaret_e_psikanalizes@nyjelakim.net***
Tarifa hyrëse për seminarin – 2500 lekë , për studentët nën 26 vjeç – 1500 lekë.
Për më shumë informacione vizitoni faqen tonë zyrtare ***www.nyjelakim.net***

Seminari i Fushës Frojdiane në Shqipëri : 2017-2018
Transferenca në veprën e Frojdit

Sesioni i parë
Transferenca në veprën e Frojdit

Frojdi e shkëputi me ngadalësi psikanalizën nga metodat e ndryshme të trajtimit psikik të cilat përdornin fjalën e që e kanë shoqëruar gjithmonë artin e shërimit. Nga sugjestionimi hipnotik te metoda e *catharsis-it* për të mbërritur në fund te psikanaliza, për Frojdin kemi të bëjmë gjithmonë me të njëjtën çështje : si të dallojmë ç'është sugjestionim e ç'është transferencë ?

Shpikja e asociacionit të lirë do ta zhvendosë këtë çështje : mjeku nuk është më autoriteti nga ku niset një sugjestionim, është fjala që vishet me pushtet. Frojdi do ta konceptojë transferencën si përfshirja e psikanalistit në psikanalizën e një të analizuari. Në vend të jetë një agjent "i jashtëm", psikanalisti paraqitet i përfshirë në jetën psikike të analizuarit.

Do të shqyrtojmë tekstet e para frojdiane mbi transferencën me hezitimet dhe pyetjet që e shoqërojnë.
Ç'është transferenca? A është përsëritje ? A është dashuri ? A është motorri i një kure apo rezistenca e saj?
A lidhet me *imagon paterne* ? Si duhet t'i qasemi ?

- S. Freud: '*Traitement psychique*'; 1890 (ne frëngjisht)
- Standard Edition tome VII, '*Psychical Treatment*' (në anglisht)
- '*La dynamique du transfert*' (1912); '*Observations sur l'amour de transfert*' (1915), në vëllimin '*La technique psychanalytique*', P.U.F.

Geert Hoornaert

PROGRAMI

9h00 - 9h30 :	**Hapja e Regjistrimeve**
9h30 - 11h00 :	Ekspoze nga **Geert Hoornaert**
11h00 - 11h45 :	Diskutim me pjesëmarrësit
11h45 - 12h00 :	*Pushim*
12h00 - 13h00 :	Prezantim klinik : "*Të kam zemër"* **Sonilda Barjamaj** Qendra Sociale Multidisiplinare pranë Bashkisë Tiranë
13h00 - 14h00 :	Diskutim teoriko-klinik me **Geert Hoornaert**